

DITARI MUJOR

MAJ 2025



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
MINISTRË SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

CEREMONIA E ÇMIMIT "KARLI I MADH", LAUREATJA URСULA VON DER LEYEN: SHQIPÉRIA, SHEMBULL PËR INTEGRIMIN NË BE!

Kryeministri Z. Edi Rama dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adeja Pirdeni, morën pjesë në ceremoninë e ndarjes së Çmimit Ndërkombëtar "Karli i Madh" (Karlspreis), në qytetin historik të Aachen-it, Gjermani.

Veprimtaria e këtij viti përkoi me 75-vjetorin e krijimit të çmimit emblematik, duke i dhënë një domethënie të veçantë përmasave simbolike dhe politike të saj.

Çmimi "Karlspreis" përbën një nga nderimet më të larta që jepen në Evropë për figura dhe institucione që kanë kontribuar ndjeshëm në forcimin e unitetit evropian, në thellimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare dhe në mbrojtjen e vlerave fundamentale të demokracisë, lirisë dhe paqes.

Laureatja e këtij viti ishte Presidentja e Komisionit Evropian, Znj. Ursula von der Leyen, për kontributin e saj në forcimin e unitetit evropian. Gjatë fjalës së saj pëershëndetëse, Dr. Ursula von der Leyen tha se Shqipëria është shembull për integrimin në Bashkimin Evropian. Ndërkohë, Mbreti Felipe VI i Spanjës e cilësoi von der Leyen si "mishërimin e shpirtit evropian", duke vlerësuar rolin e saj udhëheqëse.



AACHEN, MINISTRJA PIRDENI MERR PJESE NË FORUMIN EVROPIAN KARLSPREIS: INTEGRIMI NË BE, KATALIZATOR PËR NDËRTIMIN E INSTITUCIONEVE!

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adeja Pirdeni, mori pjesë si folëse në panelin e nivelit të lartë të Forumit Evropian Karlspreis 2025 me temë: "Më shumë Evropë për një Evropë më të forte?".

Në këtë diskutim, ku ishin të pranishëm liderë nga Ballkani Perëndimor dhe përfaqësues të lartë të institucioneve evropiane, ministra Pirdeni ndau përvojën shqiptare si një histori transformimi, nga një vend me institucione të brishta, në një shtet që ka përqafuar reformat si rrugën e vetme drejt së ardhmes.

Ministrja Pirdeni theksoi se integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një proces teknik apo synim ekonomik, por një katalizator për ndërtimin e institucioneve të besueshme, për forcimin e sundimit të ligjit dhe modernizimin e qeverisjes.

Më tej, ministra shprehu mirënjojen ndaj Forumit Evropian Karlspreis 2025 përmundësinë që i dha për të folur, si evropiane mes evropianësh, mbi të ardhmen e përbashkët.

Gjatë kësaj ngjarjeje të nivelit të lartë, u organizuan takime dypalëshe mes liderëve politikë, u organizuan panele me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të diplomacisë evropiane, të botës akademike, përfaqësuesve të shoqërisë civile, si dhe të rinjve nga mbarë kontinenti.



BRUSEL, HAPEN NEGOCIATAT PËR GRUP-KAPITULLIN III "KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA GJITHËPËRFSHIRËSE"

Këshilli i Bashkimit Evropian ka miratuar qëndrimin e përbashkët të BE-së për çeljen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë mbi 8 kapituj të rinj të grup-kapitullit III "Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse", duke shënuar një tjetër hap të rëndësishëm historik përpëra në negociatat e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Në Bruksel, Shqipëria hapi zyrtarisht grup-kapitullin III "Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse" në Konferencën e V-të Ndërqeveritare.

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adeja Pirdeni ishte pjesë e delegacionit shqiptar që kryesohej nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Z. Igli Hasani, me prezencën e Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatores Znj. Majlinda Dhuka, si dhe një delegacion të përbërë nga negociatorët përgjegjës për kapitujt përbërës. Takimi i mbajtur në Bruksel shënon një tjetër moment të rëndësishëm përrugëtimin integrues të Shqipërisë drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian, në përputhje me metodologjinë e rishikuar të zgjerimit, e miratuar nga Unioni në vitin 2020.



DITARI MUJOR

MAJ 2025



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
MINISTRË SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

TIRANË, MINISTRJA PIRDENI NË SAMITIN E KOMUNITETIT POLITIK EVROPIAN: "NJË EVROPË E RE NË NJË BOTË TË RE"

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorruptionin, znj. Adea Pirdeni, mori pjesë në Samitin e VI-të të Komunitetit Politik Evropian, i cili u zhvillua për herë të parë në Tirana, nën kujdesin e veçantë të Kryeministrat Edi Rama, duke e vendosur Shqipërinë në qendër të vëmendjes së diplomacisë evropiane dhe dialogut politik ndërkombëtar.

Nën motion "Një Evropë e re në një botë të re: unitet – bashkëpunim – veprim i përbashkët", samiti mbloodi 47 krerë nga e gjithë Evropa. Në samit morën pjesë gjithashtu përfaqësues të lartë të institucioneve evropiane, përfshirë Presidentin e Këshillit Evropian, z. António Costa, Presidenten e Komisionit Evropian, z. Ursula von der Leyen, dhe Presidenten e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, z. Rutte etj.

Ministrja Pirdeni ishte pjesë e delegacionit shqiptar, i kryesuar nga Kryeministri Edi Rama, në një sërë takimesh të nivelit të lartë me krerë shtetesh dhe qeverish, ku u trajtuan çështje të rëndësishme për të ardhmen e Evropës dhe rajonit.

Ministrja Pirdeni mori pjesë në takimet dypalëshe me: z. Antonio Costa, President i Këshillit Evropian; z. Petteri Orpo, Kryeministër i Finlandës; Lartmadhérinë e Tij Albertin II, Princ Sovran i Monakos; z. Christian Stocker, Kancelar i Austrisë; z. Nikos Christodoulides, President i Qipros; z. Dick Schoof, Kryeministër i Holandës; z. Bart de Wever, Kryeministër i Belgikës.



SANTO DOMINGO, MINISTRJA PIRDENI KRYESON DELEGACIONIN SHQIPTAR NË KONGRESIN BOTËROR TË LIGJIT 2025

Ministrja Pirdeni, kryesoit delegacionin shqiptar në punimet e "Kongresit Botëror të Ligjit 2025" në Santo Domingo. Delegacioni shqiptar, përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme qeveritare dhe institucioneve të pavarura të drejtësisë. Ministrja Pirdeni, foli në forumin "Roli i gruas në konsolidimin e sundimit të ligjit", ku u ndal gjerësishet te roli i pazëvendësueshëm i grave dhe vajzave në forcimin dhe garantimin afatgjatë të reformave shtetndërtuese në Shqipëri. Nga reforma e paprecedentë në drejtësi, te rritja e përfaqësimit në pozicione kyçe të vendimmarjes, e deri te çuarja përparrë e projektit historik të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, tha ministrja Pirdeni, gratë dhe vajzat përfaqësojnë forcën transformuese që po e ndryshon Shqipërinë.

Sakaq, Shefja e Kabinetit, Znj. Fotjona Taçë, mori pjesë në forumin "Inovacionet në praktikën e ligjit dhe përdorimin e Inteligjencës Artificiale", ku theksoi se drejtësia dhe ligji po riformësohen nga teknologjia, dhe se Shqipëria mbetet në vijën e parë të inovacionit në praktikën ligjore.

Tirana do të mirëpresi edicionin e Kongresit Botëror të Ligjit në vitin 2027.



Ministri i Shtetit për Administratën
Publike dhe Antikorruptionin
Adea Pirdeni



mapa.gov.al
adeapirdeni



APirdeni